



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nismë e deputetes Vasilika Hysi. *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Silva Caka, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë,

Adrian Shega - Drejtori i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Julian Hodaj- Zëvendësministër i Brendshëm

Aulona Mersini - këshilltare në Ministrinë e Brendshme:

Kostaq Beluri - prokuror në Sektorin e Verifikimit të Integritetit, në Prokurorinë e Përgjithshme

Gerti Loli - Oficer i Policisë Gjygjësore në Drejtorinë e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjon Juncaj - këshilltar i OPDAT-it

Brunilda Jani

Klodiana Vogli - nga EURALIUS-i

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Ju kërkohet ndjesë për vonesën për shkak të spostimit të axhendës së Kryetarit të Kuvendit, që ishte planifikuar për në orën 12:00, por u afrua për në orën 10:00. Për këtë arsye u detyruam të shtyjme mbledhjen e komisionit për këtë orë.

Hapim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Kuorumi për fillimin e mbledhjes është i pranishëm.

Sot kemi vetëm një çështje në rendin e ditës. Është shqyrtimi në parim i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”

Kjo është nismë e deputetes Vasilika Hysi. Ne jemi komision përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji. Janë dy relatorë. Është kolegu Hyseni dhe kolegja Xhina.

Në fakt është një nga 27 projektligjet e paketës së dytë të reformës në drejtësi. Është një projektligj shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore si një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e hetimit të veprave penale.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Toni Gogu, zëvendësministër i Drejtësisë dhe zoti Ardian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe i Harmonizimit të Legjislacionit.

Nga Ministria e Brendshme kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Julian Hodaj, zëvendësministër dhe zonja Aulona Mersini këshilltare.

Nga Prokuroria e Përgjithshme nuk e di nëse kanë ardhur përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme. Është zoti Kostaq Beluri, prokuror në sektorin e Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe zoti Gerti Loli, oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe të Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga misioni i OBDAT-it kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Gjon Juncaj, këshilltar dhe zonja Brunilda Jani.

Nga misioni Euralius është zonja Klodiana Vogli. Nuk e di nëse janë të pranishëm në sallë përfaqësuesit e këtyre institucioneve që kanë konfirmuar pjesëmarrjen.

Do t'ju lutem që sot të jemi produktivë në diskutimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji. Do ta miratojmë vetëm në parim projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”

Pa humbur kohë unë po ia jap fjalën nismëtares së këtij projektligji, koleges sime Vasilika Hysi, për të bërë një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Përsëritje, të nderuar kolegë!

Në fakt, projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” është pjesë e paketës së projektligjeve të hartuara nga grupi i ekspertëve të nivelit lartë vendas dhe ndërkombëtarë, në kuadër të reformës në drejtësi. Në fakt, vihet në një projektligj të ri për disa arsye, pasi analiza e sistemit të drejtësisë, lidhur me organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka evidentuar një sërë dobësish të lidhjeve të oficerëve të caktuar në seksionet e prokurorisë. Kemi bërë ndryshime në 2010-n në ligjin e Policisë Gjyqësore dhe ne që kemi qenë deputetë në atë kohë e kuptuam se çfarë hapi mbrapa u bë duke hequr procedurën e konkurrimit të oficerëve dhe emërimin e tyre në bazë të meritokracisë. Gjithashtu, pati dhe probleme të tjera që lidheshin me lëvizjet dhe transferimet e shpeshta të tyre, mosnjohja nga prokurorët e organikave, apo fakti që shpeshherë punonjësit e Policisë Gjyqësore ngarkohen dhe me shumë detyra të tjera administrative, si dhe nuk i lënë të përqendrohen në detyrën e tyre bazë.

Bazuar në këtë dokument grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë arriti në përfundimin se ka nevojë për një organizim dhe një ndryshim të organizimit dhe funksionimit të Policisë Gjyqësore për t'u dhënë zgjidhje një sërë problemeve. Unë i përmenda, por ka edhe shumë të tjera që ju mund t'i gjeni në Dokumentin Analitik të Sistemit të Drejtësisë dhe në planin e veprimit të hartuar, në kuadër të reformës në drejtësi.

Gjithashtu, të nderuar kolegë,

Do të doja t'ju sillja në vëmendje që ne kemi miratuar një ligj për organet e qeverisjes, ku i kemi dhënë kompetenca të reja Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kemi një ligj të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë. Është miratuar edhe ligji për krijimin

e strukturave të posaçme që do të hetojë akuzat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Dhe, për rrjedhojë, paketa e ligjeve që tashmë është miratuar dhe është në fuqi, duhet të harmonizohet edhe me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”

Dua të theksoj se në këtë ligj jemi treguar të kujdesshëm të saktësojmë mirë parimet e organizimit dhe të funksionimit, për të shmangur atë përplasje ose paqartësi që kemi pasur sot si me seksionet, por dhe me shërbimet e Policisë Gjyqësore.

Gjithashtu, qartësohet mirë marrëdhënia e Policisë Gjyqësore me Byronë Kombëtare të Hetimit. Njëkohësisht ligji i jep një rol të rëndësishëm Këshillit të Lartë të Prokurorisë lidhur me emërimet, promovimet, transferimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Ajo që dua të theksoj është se ka një qartësim lidhur me rolin dhe funksionet që kanë shërbimet dhe strukturat e Policisë Gjyqësore. Rol i veçantë i është kushtuar trajnimit fillestar për të hyrë në këtë lloj shërbimi, por dhe formimit vazhdues. Dhe nuk mund të vazhdojmë që në shërbimet e Policisë Gjyqësore ose oficerë të Policisë Gjyqësore, që kryejnë veprime shumë të rëndësishme në lidhje me hetimin, të kemi individë të cilët nuk kanë formimin e duhur në drejtësi. Pra, nuk njohin Kodin e Procedurës Penale, nuk njohin ligjin dhe janë thjesht me një kurs të thjeshtë dhe të shkurtër hetimi.

Nga ana tjetër sot hetimi i veprave penale nuk ka nevojë vetëm për juristë, por ka nevojë edhe për profesionistë të tjerë që mund të jenë financierë, ekonomistë, bankierë, specialistë në sistemet elektronike, për t’u përballur edhe me krimin kibernetik, edhe format e tjera të kriminalitetit.

Njëkohësisht ligji në një kapitull të veçantë rregullon përgjegjësinë disiplinore duke i qartësuar qartë se cilat janë shkeljet, masat etj.

Në përfundim, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Dua të theksoj se ky ligj i është nënshtruar konsultimit publik që nga viti 2017. Ka pasur disa tryeza. Është një ndër ligjet që ka pasur një *feed back* dhe një reagim shumë aktiv nga trupa e oficerëve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorive të disa rretheve, ku, në mënyrë të veçantë do të përmend dhe do të vlerësoj trupën e oficerëve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorëve të rretheve Tiranë, Fier, Vlorë, Elbasan, Korçë, që kanë

shprehur shumë mendime dhe sugjerime, lidhur me organizimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Por kemi shumë komente dhe sugjerime nga Organizata e të Drejtave të Njeriut që monitoron policinë, prokurorinë dhe ka përvojë në këtë fushë dhe nga organizata ndërkombëtare.

Ndaj unë pajtohem me ju, zoti kryetar, që sot ne të mbetemi te diskutimi dhe miratimi në parim i ligjit, pasi me kërkesën tuaj dhe udhëzimet që ju keni dhënë, ne kemi dërguar projektligjin për konsultim, kemi marrë opinione, kanë ardhur shumë mendime dhe sugjerime, të cilat do të printohen. Sikurse ju kanë ardhur elektronikisht, ju mund t'i merrni edhe të printuara në sekretarinë e Kuvendit.

Ndërkohë është ngritur grupi i punës bashkë me ekspertët që kanë qenë pjesë e ekspertëve të nivelit të lartë, por edhe ekspertë të sekretariatit teknik, si dhe profesionistë për të marrë një nga një në analizë mendimet, rekomandimet, sugjerimet e sjella.

Falënderoj kolegët, në mënyrë të veçantë relatorët për praninë e tyre në këtë konsultim!

Si propozuese e këtij ligji, jam e hapur, të mirëpres çdo rekomandim dhe sugjerim që e përmirëson atë.

Ulsi Manja - Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Faleminderit!

Faleminderit, zonja Hysi!

Sot kemi për diskutim dhe miratim projektligjin “Për funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Unë nuk do të ndalem gjatë, do t'i lë kohë koleges për të bërë ajo një përmbledhje të ligjit, por, duke e konsideruar të ezauruar me argumente shteruese prezantimin e ligjit nga kolegja Hysi, do të doja të sillja në vëmendje që në kuadër të reformës vjen tashmë një projektligj i ri. Ka pasur shumë diskutime, ka pasur shumë debate, nëse do të vinim me një projektligj të ri ose do të vazhdonim me formatin e ndryshimit të disahershëm të ligjit të kaluar. Duke qenë se ne hymë në një proces të thellë të reformës në drejtësi, duke qenë se në tërësinë e tyre e gjithë struktura e sistemit të drejtësisë është formatuar ndryshe, institucionet e drejtësisë janë kornizuar, le të themi, totalisht ndryshe, kërkesat e të gjitha palëve të interesuara, palë të cilat shpesh kanë synimin e njëjtë, por metodat dhe mënyrat e realizimit të synimit mund të mos kenë qenë të njëjta, këtu e kam fjalën për

policinë prokurorinë, të cilat kanë pasur orientime të ndryshme të pozicionimit të rolit të Policisë Gjyqësore, unë mendoj se sot ka vend për të diskutuar nëse jemi në rregull me këtë rrugë, do të ecim me këtë format të një ligji të ri, është e domosdoshme apo jo që ne të kalojmë me një ligj të ri, i cili do të bëjë rregullimet e shumë elementeve, të cilat në vite kanë krijuar problematika dhe, gjithashtu, nëse është e domosdoshme me këtë formulim që kemi dhe me përmirësimet që do të bëjmë të mos kemi më problematika në lidhje me hetimin, sepse hetimi që bazohet te Policia Gjyqësore ka çaluar shpeshherë dhe ka qenë një ndër elementet më të atakuar në të gjitha raportet ndërkombëtare sa i takon goditjes së kriminalitetit. Tek e fundit, pa një hetim të mirë cilësor dhe profesional çdo reformë që mund të bëjmë ne do të na cedojë në rezultatin përfundimtar, që është goditja e kriminalitetit, prandaj unë në parim, si relatori, do të ftoja që sot ta miratojmë. Do të kemi shumë punë ne, si grup relator, së bashku me kolegen Hysi si iniciatore, me kolegët e Ministrisë së Brendshme, me kolegët e Ministrisë së Drejtësisë, në veçanti me ekspertët e prokurorisë, ekspertë të tjerë. Kanë ardhur me dhjetëra e dhjetëra sugjerime, si rrallë herë në projektligje të tjera, edhe dje, edhe sot kanë ardhur të tjera. Kjo tregon jo thjesht interes, por edhe vend për të punuar duke na dhënë mundësinë, pasi ta kalojmë sot në parim, që të ulemi të punojmë gjatë duke pritur edhe sugjerime nga kolegë të tjerë të komisionit dhe nga gjithë të tjerët dhe besoj se do të dalim në një ligj që të mos kontestohet të paktën në një periudhë të gjatë.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Po, relatorja, zonja Xhina.

Elena Xhina- Faleminderit!

Dua të falënderoj nismëtares e këtij projektakti, zonjën Hysi, gjithashtu edhe ekspertët që kanë punuar për riformulimin e dispozitave të këtij projektakti. Mendoj që jemi në kohën e duhur për të pasur një ligj të ri për funksionimin e Policisë Gjyqësore, e cila është një nga hallkat më të rëndësishme të hetimit, veprime procedurale parandalimit të krimit dhe mendoj që këtij projektligji duhet t'i jepet vendi i duhur, kompetencat e duhura për të rregulluar marrëdhëniet e varësisë së oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe duke rregulluar karrierën e tyre, trajnimin e tyre vazhdues e të tjera, pasi ka nevojë për një punë serioze dhe për këtë ne falënderojmë disponibilitetin e ekspertëve, si dhe nismëtares së ligjit.

Duhet bërë një unifikim i terminologjisë, duhet shikuar me kujdes varësia e oficerëve të Policisë Gjyqësore, kompetencat që ata kanë, duhet bërë një harmonizim i këtij projektakti me ligjin për prokurorinë, me ligjin për Policinë e Shtetit, me ligjin për organet e reja të sistemit të drejtësisë. Është një punë voluminoze, e cila do t'i japë vendin e duhur strukturës së Policisë së Shtetit për të harmonizuar sa më mirë punën e kësaj strukture, të prokurorisë dhe efikasitetin e këtyre punonjësve në parandalimin e krimit dhe veprimeve procedurale të ngarkuara me ligj.

Në këto kushte ftoj të gjithë kolegët e mi ta miratojnë në parim këtë projektakt duke qenë se është paraqitur në raport të drejtë me Rregulloren e Kuvendit, Kushtetutën dhe më pas kemi mundësi të punojmë me të!

Ulsi Manja - Përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtësisë, ju lutem, na jepni opinionin tuaj lidhur me projektligjin.

Toni Gogu- Zoti kryetar, për të mos rënë në përsëritje, për të gjitha arsyet e përmendura, Ministria e Drejtësisë e mbështet plotësisht në parim miratimin e këtij projektligji, si një projektligjet shumë të rëndësishme të reformës së drejtësisë penale, por, gjithashtu, shprehim gatishmërinë tonë për t'iu bashkuar grupit të punës dhe për të harmonizuar të gjitha çështjet, të cilat kanë nevojë të harmonizohen, si me kornizën ligjore në fuqi, ashtu edhe me akte të tjera, të cilat do të vijnë.

Ulsi Manja- Zoti Hodaj.

Julian Hodaj- Nuk do të përsëris kolegun, por edhe Ministria e Brendshme është dakord në parim për këtë projektligj dhe të gjitha çështjet dhe sugjerimet që ne kemi janë të zgjidhshme në shqyrtimin nen për nen dhe në grupin e punës.

Kostaq Beluri – Prokuroria e Përgjithshme është dakord për miratimin në parim. Vlerësojmë punën e bërë për draftin, ne do të jemi shumë bashkëpunues gjatë kësaj kohe për të dhënë mundësi që të përshtatim nenet me ligjet e miratuara paraprakisht, të mos ketë kontradikta në mes tyre pasi, konstatojmë në 2-3 raste kontradikta me ligjin.

Ulsi Manja- Nga përfaqësuesi i misioni Euralius, ju lutem një konsideratë për projektligjin.

A ka OPDAT-i përfaqësues në sallë?

Klodiana Vogli – Unë jam Klodiana Vogli, përfaqësuese e Euraliusi –it. Këtu jam si vëzhguese, megjithatë mund të them se Euralius-i, ashtu siç ka bërë deri tani, do të

vazhdojë mbështetjen jo vetëm në miratimin në parim, por edhe në shqyrtimin nen për nen.

Ulsi Manja – A ka pyetje nga kolegët para se ta hedhim në votim?

Po zoti Fino.

Bashkim Fino- Së pari, a ka pasuar ndonjë evolucion ky projektligj që zonja Hysi na ka sjellë këtu për shkak se e ka depozituar që në shtator të vitit 2017?

Së dyti, më lanë të kuptoja me gjithë këtë rezumë të shpejtë, mbase për shkak se e filluam vonë, zëvendësministrat, prokuroria dhe të gjithë të tjerët, që janë dakord me këtë draft, por ne, bashkë me ekspertët tanë, do të jemi shumë bashkëpunues që të punojmë për të rregulluar çdo nen hap pas hapi. Që do të thotë, ne si anëtarë komisioni do të kemi një draft integral, të cilin sot nuk e kam. Këtu kam një draft të vitit 2017, kam një relacion që e respektoj shumë, të cilin e kam lexuar e nënvizuar. Nuk jam kundër në parim për të votuar, por, në qoftë se paraprakisht do të kisha punën e grupit të ekspertëve dhe një draft integral, mbi bazën e të cilit mund të bëjmë ndryshime si deputetë, dhe kjo është logjika për ndryshimet që kërkojnë edhe grupet e interesit, qeveria, por sidomos edhe prokuroria, atëherë ne do të jemi më efektivë në punën tonë.

Është marrë një nismë, është bërë një material thjesht për të filluar nga procedura, por një draft integral me grupin e ekspertëve do të duhej ta kishim mbi tryezë. Ndaj edhe bëra pyetjen nëse ky draft ka pësuar ndonjë evoluim që nga viti 2017 deri tani, apo është thjesht një draft që do ta pësojë këtë evoluim duke filluar nga mbledhja e ardhshme, në vazhdim.

Pavarësisht se ju, kryetar, nuk dëgjoni, pyetja ime regjistrohet dhe le të më kthejë përgjigje kush e ka atë dëshirë ta bëjë.

Ulsi Manja - Fjala për nismëtare e projektligjit, zonjën Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Besoj se ky projektligj është në përputhje me rregullat e brendshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe të veprimtarisë së komisionit, që një projektligj gjatë diskutimit nen për nen mund të ndryshojë me propozimet për shkak të konsultimit publik, për shkak të rekomandimeve që mund të japin vetë relatorët, por edhe të amendamenteve që mund të bëjnë kolegët deputetë, anëtarë të Komisionit të Ligjeve, por edhe në seancë plenare, çdo deputet ka të drejtë të depozitojë 24 orë përpara rekomandimet e veta.

Sikurse thashë, kanë ardhur shumë mendime dhe sugjerime, të cilat janë shpërndarë nga sekretaria e komisionit në *e-mail*-in e të gjithë deputetëve. Është detyrimi ynë, edhe në bazë të strategjisë së konsultimit publik, që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë, edhe të ligjit “Për konsultimin”, që t’i marrim e t’i analizojmë një për një dhe të japim përgjigje.

Është kjo arsyeja që është ngritur grupi i punës i përbashkët midis meje, si propozuese, ekspertëve që e kanë draftuar, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, dy relatorëve, njëkohësisht, edhe me përfaqësuesit e institucioneve. Çdo sugjerim, koment, apo vërejtje që kanë bërë do të merren një nga një në shqyrtim, edhe të institucioneve vendase, edhe propozimet që japin organizatat ndërkombëtare, kryesisht OBDAT-i, por njëkohësisht edhe organizatat e shoqërisë civile.

Ju ftoj, gjithashtu, edhe ju, të nderuar kolegë, nëse secili nga ju ka komente për nene konkrete, ose ka dëshirë të jetë pjesë e grupit të konsultimit që është ngritur, në vazhden e traditës që ka vendosur komisioni ynë paraprakisht dhe më pas e ka marrë i gjithë Kuvendi, janë të mirëpritur.

Duke filluar nga dita e nesërme e në vijim do të punojmë pas orarit të komisioneve për të marrë parasysh këto komente.

Gjithashtu, do të doja t’i thosha kolegut Fino që para se të fillojë diskutimi nen për nen, të gjithë deputetët do ta kenë këtë tabelë (*tregon tabelën*), siç është ligji, cilat janë propozimet e ardhura, cilat do të pranohen dhe për ato që nuk pranohen, për të pasur transparencë do të ketë diskutime përse nuk pranohen.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Fjala për zotin Hyseni.

Alket Hyseni – Shqetësimi i zotit Fino është shumë i drejtë. Ai është njëri prej deputetëve me më shumë eksperiencë në parlament dhe në këtë komision, ndoshta më shumë se të tjerët. Unë e quaj të nevojshme ndërhyrje që bëri.

Duke parë që jo thjesht ky ligj, por shumë ligje, pasi janë kaluar, kanë sjellë problematika në zbatimin në terren, si dhe pasoja të paparashikuara, gjykuam të mos nxitohemi në këtë hap, të marrim miratimin në parim nga komisioni për ta futur në procedurë e për të thënë që po i hyjmë këtij ligji të ri proceduralisht, kemi ngritur grupin

që tha kolegja Hysi, grup i cili koordinohet nga të dy relatorët, pasi tashmë ka hyrë në procedurën parlamentare dhe nuk koordinohet më nga ekspertët dhe nga të tjerët.

Besojmë se ka shumë nevojë për t'u punuar, zoti Fino, ndoshta jo çdo nen, por në masën dërmuese do të punohet me synimin për ta përmirësuar dhe për të mos sjellë pasoja për të cilat do të na duhet të rimblidhemi në parlament mbas një viti e të korrigojmë gjërat, sepse vetë ligji është delikat për shkak të asaj që unë thashë, e gjithë struktura e sistemit të drejtësisë tashmë është me pozicionet e reja, ndaj të shohim ku e gjen veten më mirë Policia Gjyqësore, ku ndihen më mirë funksionet e saj, në funksion edhe të qëllimit të saj.

Mendoj që këtë ligj sot duhet ta miratojmë në parim. Puna në vijim do të jetë e madhe dhe neve si grup pune do të na shërbejë eksperiencia qoftë profesionale, qoftë edhe jashtë profesionit, siç do të na shërbejë shumë më tepër eksperiencia e zotit Fino, por edhe e ekspertëve të mirëfilltë, të cilët që nga dita e hënë do të fillojnë të hartojnë projektligjin.

Ditën e hënë grupi do të fillojë punën dhe javën tjetër besoj se do të kemi materialin e integruar, i cili përsëri nuk do të jetë përfundimtar, por do të jetë materiali bazë i punës për të vazhduar diskutimet nen për nen.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Para se ta hedh në votim, kam pak gjëra për të sjellë në vëmendjen e kolegëve të komisionit, relatorëve, por edhe të nismëtares. E vlerësoj maksimalisht angazhimin e gjithsecilit për punën që kanë bërë për ligjin e Policisë Gjyqësore. Është një projektligj që duhet të marrë vëmendjen e duhur, sepse kemi një organ të ri që krijohet për shkak të reformës në drejtësi, që është Këshilli i Lartë i Prokurorisë, roli i ri kushtetues në Republikën e Shqipërisë, është Kodi i ri i Procedurës Penale, që ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017, janë organet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, SPAK-u, që pritet të ngrihet shumë shpejt me ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë edhe çështjet e trajnimit vazhdues për Policinë Gjyqësore, trajtimi financiar i saj, që tashmë ne e dimë, që për shkak të ndryshimeve kushtetuese, laboratorit i vetëm nga ku do të dalin gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm, është Shkolla e Magjistraturës. Këtu do t'u kërkoja relatorëve të jenë të vëmendshëm për

të marrë në konsideratë trajtimin e duhur financiar lidhur me Policinë Gjyqësore edhe për shkak të mbylljes së sistemit të karrierës për t'u bërë prokurorë.

Për të gjitha këto probleme, unë do të jem pjesë aktive e grupit të punës, edhe për shkak se vij nga sistemi i drejtësisë penale, e njoh shumë mirë rolin e Policisë Gjyqësore dhe rëndësinë e kësaj strukture në hetimin e veprave penale, pse jo edhe me sugjerimet shumë dashamirëse dhe të duhura të kolegut Fino, që ky projektligj, në variantin fillestar që është depozituar, natyrisht që ka probleme, të cilat nuk ishin parashikuar në kohë dhe në gjithë gjerësinë e vet. Fatmirësisht, jemi në kohë, sot kemi vetëm miratimin në parim, por jam i bindur që në të ardhmen, me këtë gatishmëri të kolegëve, por edhe të përfaqësuesve të ministrisë, Prokurorisë së Përgjithshme, misionit EURALIUS, OPDAT-it, por edhe të oficerëve të Policisë Gjyqësore, që u theksua këtu, si rrallë herë kanë pasur angazhim direkt në përmirësimin e këtij ligji, më vjen mirë që mbërritëm te ky moment për ta votuar në parim dhe pastaj për të hapur fazën e diskutimit dhe miratimit nën për.

E hedhim në votim në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim!

Me këtë votim, të nderuar kolegë, e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Gëzuar Ditën e Europës!

MBYLLET MBLEDHJA

